



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **50**

Prishtinë, më 19.6.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Lulzim Zeneli, Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Heset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi.

Munguan :Zulfi Merxha, Zef Morina, Dragiša Mirić, Ali Lajçi.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Nga Sekretaria Ismet Krasniqi dhe Xheladin Hoxha, dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Mustafë Nuhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Lulzim Zeneli**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Fondi financiar i komisionit-sqarime,
3. Stafi mbështetës i komisionit.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Fondi financiar i komisionit-sqarime

Lulzim Zeneli njoftoi komisionin se ka biseduar me Sekretarin për fondin e komisionit prej 10.000 euro, gjysma e së cilës është proceduar për shërbime e mallra ngase nuk janë shqyrtuar nga komisioni, pjesa tjetër prej 5.000 euro (për 6 mujorin e dytë) i takojnë komisionit dhe ato mund të planifikohen tani e tutje, në shtatorë. Reagoi **Berat Luzha** sepse nuk kanë kaluar ende 6 muaj, mirëpo sqarimi nga kryetari ishte se vetëm një komision deri tani kishte shfrytëzuar këtë të drejtë përkundër faktit se për këtë çështje komisionet vonë janë njoftuar.

3. Stafii mbështetës i komisionit

Lulzim Zeneli kërkoi fillimisht sqarim nga **Xheladin Hoxha** lidhur me këtë pikë, i cili tha se Departamenti Ligjor shpejt do ta funksionalizoi projektin me të cilin parashihet çdo komision të ketë nga dy zyrtarë, njëri për këshilla tjetri për punë zyrtare, mirëpo kryetari tha se kjo nuk mjafton kështu si është tani.

Naim Maloku theksoi se për punën e deritanishme në këtë komision me siguri janë të bazuara kërkesat e parashtruara për plotësim të stafit, mirëpo përkundër kësaj ai në këtë komision ka vërejt një azhuret më të madh se sa në komisionet tjera, ngase për të gjitha punët që punohen në komision, shkresat dërgohen me kohë dhe me rregull, gjithashtu procesverbalet janë të miratuara rregullisht :”qysh po i ndanë punët Bajrami nuk e di, por njeri po punon”.

Selvije Halimi tha se me kërkesën e sajë për staf nuk ka deshtë të kritikoj stafin ekzistues (Bajramin) por ka pyet pse në këtë komision nuk është si në komisionet tjera përkatësisht pse ky komision ka vetëm një zyrtar, sepse me pas më tepër staf më mirë do të shkojnë punët e komisionit, si p.sh. propozimet e Qeverisë dhe shumë shkresa tjera më mirë do të shqyrtoheshin dhe më qartë, më në fund edhe procesverbalet do të ishin më gjithëpërfshirës.

Myrvete Pantina u pajtua me dy parafolësit, ngase dikush duhet ti ndihmoi koordinatorit, jo pse ai nuk po mundet por komisionit duhet ti takoj më tepër se një zyrtar, ajo përfundoi “po të isha në vend të koordinatorit nuk isha pajtua assesi me këtë gjendje ekzistuese derisa nuk më sjellin edhe ndonjë zyrtar tjetër”.

Elhame Hetemi u pajtua me Selvie Halimin sepse një zyrtar nuk mund ti mbërrij të gjitha punët me i punua si duhet.

Berat Luzha u pajtua se koordinatori ka qasje korrekte në punë por ka edhe gabime (p.sh.interpretimi i konkluzave të fundit lidhur me vendimin e Qeverisë), të cilat nuk mund të mbulohen thjeshtë vetëm duke marr shënime, duhet të incizohen mbledhjet me diktafon dhe të ketë transkripte nga mbledhja, ose me një fjalë të shtrohet çështja e riorganizimit të stafit të komisioneve, si dhe një këshilltarë ligjor të ketë komisioni.

Naim Maloku u bashkëngjiti kërkesës së Berat Luzhës për tu pajisur sallat me pajisje për transkripto edhe diktafon, ndërsa lidhur me konkluzionet e fundit ai tha se dallimi në komision ka qenë të mbështetet propozimi i Qeverisë dhe ti dërgohet Kuvendit apo të procedohet ashtu si është në Kuvend për miratim, për çka komisioni ka vendosur për variantin e dytë. Ai përfundoi me konstatimin se duhet të avancohet puna e stafit të komisionit.

Lulzim Zeneli u pajtua me parafolësit por lidhur me këshilltarë të komisionit ende duhet të analizohen rrethanat, ngase fushat që i përfshinë ky komision janë bukur të gjëra, ndaj duhet të shikohen kushtet se si të kërkohet një këshilltarë për këtë komision. Sa i përket koordinatorit të komisionit ai tha se ndoshta është duke u bërë një padrejtësi ndaj tij për shkak se ai i vetëm i kryen të gjitha punët që kërkohen, për këtë shkak janë shumë të bazuara kërkesat që dolën nga mbledhja e sotme për plotësim të stafit konform mbështetjeve në komisionet tjera, asgjë më tepër, si dhe të ketë një këshilltar komisioni, roli i të cilit duhet të përcaktohet në një takim tjetër dhe do të kërkohet nga sekretaria me një kërkesë të veçantë.

Xheladin Hoxha rikujtoi komisionin se transkriptet bëhen vetëm në seancat plenare, ndërsa për komisione ai sugjeroi të kërkohet deputetët gjatë amendamentimit të rregullores së Kuvendit duke shtuar vetëm edhe një fjalë “ transkripti bëhet në seanca plenare **dhe në Komisione**”. Ndërkaq për koordinatorin e komisionit tha se ai e ka rolin edhe të këshilluesit, ndërsa stafi teknik është dërguar (Mustafë Nuhiu). **Bajram Badivuku** reagoi se ai (ndihmësi) nuk ka tavolinë dhe kompjuterë.

Në vazhdim diskutimet u bënë rreth :

- caktimit dhe rolit të këshilltarit të komisionit me pagë (apo me honorar), se a do të jetë ligjorë, profesional etj duke cekur se pagesa me honorar nuk i përshtatet komisionit, sepse ai duhet të jetë në rrjedha,

- puna e stafit të komisionit duhet të avancohet sepse edhe mbikëqyrja parlamentare e Qeverisë duhet të jetë në nivelin më të lartë se sa është tani, sidomos :
 - duhet të iniciohet monitorimi i Ligjit për Tokat Bujqësore (Elhame Hetemi) sepse dikur do të jetë shumë vonë,
 - shpenzimet jo të harmonizuara në MMPH (pse janë harxhuar vetëm 27% të mjeteve në këtë ministri),
 - si do të përfundoi çështja e monitorimit të Ligjit për Mbeturina, a do të ketë debat publik etj (në bashkëbisedim me koordinatorin e komisionit u caktua që të ftohet përfaqësuesi i KLMC-së, ndërsa mos të thirret debati publik),
- Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

Gjatë muajit shtatorë 2009 komisioni do të shqyrtoi mundësinë e shfrytëzimit të fondit financiar të këtij komisioni, duke u fokusuar në caktimin e një këshilltari të komisionit dhe rolit të tij.

Mbledhja e radhës do të mbahet më 30 qershor 2009 në orën 13,00 kur do të shqyrtohet raporti për monitorimin e Ligjit për Mbeturina dhe do të ftohet përfaqësuesi i KLMC-së.

Projektligji për mbrojtje nga rrezatimi jonizues së shpejti do të shqyrtohet në komision pasi që të dërgohen sugjerimet nga zyrtarët ligjor të Ambasadës Amerikane.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,00, mbledhja e radhës do të mbahet më 30 qershor 2009.

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli